REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

RELACIONI TEKNIK

OBJEKTI:

VARREZAT E QYTETIT TE LEZHËS

Shoqeria “MCE” Sh.p.k
Administrator:Petrit MUJA

“TIRANË 2025”

PASQYRA E LËNDËS

RELACIONI TEKNIK 1

I. KERKESA TE PROJEKTIT 4

I.1. HYRJE. 4

I.2. KERKESA PER: NDERTIMIN 4

I.3. SKEMA E RRJETIT RRUGOR 5

I.4. TOPOGRAFIA, GJEOLOGJIA DHE HIDROLOGJIA 6

I.5. HARTIMI I PREVENTIVIT 6

I.6. STANDARDET 6

II. REALIZIMI I PROJEKTIT 8

II.1. OBJEKTIVAT 8

II.2. DOKUMENTACIONI 8

II.3. REKOMANDIME 8

III. TE PERGJITHSHME 9

III.1. HYRJE 9

III.2. POZICIONI I OBJEKTIT 10

III.3. GJENDJA EKZISTUESE 11

IV.5.1. Topografia 11

IV.5.2. Pershkrimi i terrenit 12

IV. ZGJIDHJA E PROJEKTIT 13

IV.1. SKEMA E ORGANIZIMIT 14

IV.2. FAZAT E ZHVILLIMIT 15

IV.3. KOMPOZIMI I SHESHIT TE NDERTIMIT TE VARREZAVE 17

IV.4. REKOMANDIME 19

IV.5. INFRASTRUKTURA RRUGORE 20

IV.5.3. Segmenti rrugor me dy kalime. 20

IV.5.4. Profilet 21

IV.6. Konkluzione 24

LISTA E FIGURAVE

Figure 1 Plan Rilevimi Kadastral i parceleës së varrëzave..... 9
Figure 2 Vendodhja e parcelës në raport me qytetin Lezhë 10
Figure 3 Rilevimi topografik i parcelës..... 11
Figure 4 Foto nga zona e destinuar për varreza..... 13
Figure 5 Skema funksionale e varrezave..... 15
Figure 6 Fazat e zhvillimit 16
Figure 7 Objektet e Sallës Ceremoniale dhe Morgut..... 17
Figure 8 Organizimi i një parcele me varre solitare sipas VKM Nr. 712..... 17
Figure 9 Ilustrime të varrezave..... 19
Figure 10 Profile tip të rrugëve..... 21
Figure 11 Profili Tip 1 – Rruga e Parkimit..... 22
Figure 12 Profili 2 Muri Pritës në Parkim 22
Figure 13 Profil i rrugëve brenda parcelave 23
Figure 14 Profil i Murit Prites 23

I. KERKESA TE PROJEKTIT

I.1. HYRJE.

Objekti Ndertim i Varrezave te Qytetit te Lezhës, – Bashkia Lezhë, ndodhet ne territorin e Bashkise Lezhë.

Shtrihen në veri të qytetit të Lezhës. Ndodhen në rrugën “Rraboshtë”, Njësia Administrative Kallmet, Bashkia Lezhë. Vendodhja e sheshit ku është menduar ndërtimi i varrezave publike Merqi kufizohet:

Në veri kufizohet nga parcela private, në perendim kufizohet nga kanali ujitës, në lindje kufizohet nga rruga “Rraboshtë”, në jug kufizohet nga rruga Merqi.

I.2. KERKESA PER: NDERTIM**IN**

Referuar kerkesave per ndertimin e infrastruktures rrugore e rrjeteve inxhinierike ne to, rrethimin e parceles se re si dhe konturimin e parcelave qe do te perdoren per ndertimin e varrezave solitare si dhe strukturat mbajtese e pritese të Varrezave te Qytetit te Lezhës, – Bashkia Lezhë, kërkohet:

1. Të parashikohen të gjitha punimet e nevojshme për te arritur gjeometrine qe do te parashikohet ne projekt, duke mbajtur ne konsiderate te VKM Nr. 712, datë 29.10.2014 për Miratimin e Rregullores Teknike “Për Projektimin dhe Ndërtimin e Varrezave në Territorin e Republikës së Shqipërisë” per:
   - Tipologjine e varreve nentokesore, varret vetjake (pika 2.1.1).
   - Organizimi i Varreve në parcela me varre solitare (pika 3.).
   - Rrugët me një kalim të jene me gjeresi (3÷4) m, te shoqeruara me sistem kanalizimesh
   - Rrugët me dy kalim të jene me gjeresi (5÷6) m, te shoqeruara me sistem kanalizimesh
2. Të parashikohen ndertimi i shtresave rrugore te tilla qe te perballojne fluksin e levizjeve brenda Varrezave te Qytetit.
3. Të parashikohen rrjtetet e largimit te ujerave siperfaqesore, nepermjet ndertimit te rrjeteve inxhinierike;
4. Të parashikohen ndertimet e mureve mbajtese e pritese atu ku jane te nevojshme si dhe ndertimi, riparim apo pastrimi i vepra te artit ne pikat ku rrjetet e reja intersektohen apo shkarkojne ne rrjetet ekzistuese;
5. Të perfshihen ne projekt masat stabilizuese mbrojtese si mure

mbajtese-pritese, tombino, etj, te cilat sigurojne funksionimin normal te vepres.

6. Vlera e objektit të përcaktohet sipas projektit të paraqitur me preventivin përkates të hartuar për këtë qëllim. Bazuar ne llogaritjet dhe vizatimet e projektit do te hartohet nje liste me te gjitha zerat e punimeve qe jane pjese perberese e listes perfundimtare te volumeve (Preventivi). Perpilimi i Preventivit te Punimeve dhe Analizat Teknike te Cmimeve Njesi te behet duke u bazuar ne VKM Nr. 629, date 15.7.2015, per "Miratimin e Manualeve Teknike te Çmimeve te Punimeve te Ndertimit dhe te Analizave Teknike te Tyre" (Ndryshuar me VKM nr. 631, date 26.10.2018)

7. Pervec kerkesave te dhena si me siper, projektuesit perpara fillimit te procesit te projektimit, kemi proceduar ne:

   - Rilevimin te zones ku shtrihet objekti;
   - Verifikimin paraprak ne terren i saktesise se te dhenave/azhornimeve. Kjo eshte e domosdoshme ne menyre qe te evitohen pasaktesite gjate projektimit dhe zbatimit, si rezultat i te dhenave te marra qe nuk perputhen me gjendjen ne terren;
   - Verifikimin e veprave (strukturave) ekzistuese, lidhur me gjendjen dhe funksionalitetin e tyre;
   - Evidentimin e mundesise se permiresimeve apo rakordimeve, referuar mundesive qe te ofrohen nga terreni ekzistues;
   - Analizimin e bazes mbeshtetese qe ofrojne standardet teknike te projektimit duke patur parasysh perdorimin maksimal te mundshem te materialeve rrethanore.
   - Shqyrtimin dhe analizen e burimeve te materialeve te ndertimit, duke parashikuar dhe distancat e transportit.

I.3. SKEMA E RRJETIT RRUGOR

Pas perfundimit te procesit te azhornimeve ne terren, dhe marjes ne konsiderate te VKM Nr. 712, datë 29.10.2014;

- Tipologjine e varreve nentokesore, varret vetjake (pika 2.1.1).
- Organizimi i Varreve në parcela me varre solitare (pika 3.).
- Rrugët me një kalim të jene me gjeresi (3÷4) m, te shoqeruara me sistem kanalizimesh
- Rrugët me dy kalim të jene me gjeresi (5÷6) m, te shoqeruara me sistem kanalizimesh

Duhet bere nje analize e shkurter e situates ne bashkepunim dhe me konsultim edhe me perfaqesuesit e Drejtorise se Sherbimeve, ku kemi marre edhe te dhenat / statistikat mbi ecurine e studimeve dhe ndikimin e tyre ne projekt.

Qellimi i kesaj faze eshte qe projekti te kete analize te perputhshmerise me planet, eficence ekonomike te nderhyrjes, pra efektivitet te kostos, minimizim te impakteve negative sociale (si p.sh te prishjeve te panevojshme), etj.

Kompozimi i siperfaqes se krijuar eshte bere duke u nisur nga nje modul baze sipas ”Figura 3.1 Organizimi i një parcele me varre solitare” e VKM Nr. 712, datë 29.10.2014. Eshte projektuar nje aks kryesore me dy kalim me gjeresi 6 m, i cili ka shtrirje veri – jug duke nisur nga aksi rrugor ekzistues (Rruga 1) i varrezave ekzistuese. Akset qe krijohen paralel dhe pingul aksin kryesor nga pozicionimi i modulit baze sipas ”Figura 3.1 Organizimi i një parcele me varre solitare” perbejne rrugët me një kalim me gjeresi 4 m.

I.4. TOPOGRAFIA, GJEOLOGJIA DHE HIDROLOGJIA

Zona qe perfshihet parcelat me numer pasurie: 41, 25, 26, 296 në zonën Kadastrale 2660 në fshatin Merqi, Bashkia Lezhë është kodrinore.

Zona ku bën pjesë parcela qe do te trajtohet ne kete projekt bën pjesë në nënzonën mesdhetare, me dimër të ftohtë e të lagesht dhe verë të nxehte e të thatë.

Rruget e varrezave ekzistuese qe do te trajtohen ne kete projekt ne disa zona karakterizohen nga pjerresi gjatesore deri ne 23 %. Është hartuar një Studim Hidrogjeologjik i cili evidenton faktin fenomeneve gjeologjike dhe gjeodinamike te zones.

HARTIMI I PREVENTIVIT

Ne hartimin e preventivit, vec te tjerave do te mbahen parasysh, cmime reference te Ministrise se Transporteve te INSTAT, etj, sipas akteve ligjore ne fuqi, dhe llogaritja e preventivit do te behet sipas normave dhe akteve ligjore ne fuqi per te siguruar kursimin dhe eficencen e perdorimit te fondeve.

Perpilimi i Preventivit te Punimeve dhe Analizat Teknike te Cmimeve Njesi te behet duke u bazuar ne VKM Nr. 629, date 15.7.2015, per “Miratimin e Manualeve Teknike te Çmimeve te Punimeve te Ndertimit dhe te Analizave Teknike te Tyre” (Ndryshuar me VKM nr. 631, date 26.10.2018)

I.5. STANDARDET

Standade ne Projektim:

Jane zbatuar udhezimet e VKM Nr. 712, datë 29.10.2014 për Miratimin e Rregullores Teknike "Për Projektimin dhe Ndërtimin e Varrezave në Territorin e Republikës së Shqipërisë" per:

- Tipologjine e varreve nentokesore, varret vetjake (pika 2.1.1).
- Organizimi i Varreve në parcela me varre solitare (pika 3.).
- Rrugët me një kalim jane parashikuar me gjeresi 4) m, te shoqeruara me sistem kanalizimesh
- Rruga kryesore me dy kalime eshte parashikuar me gjeresi 6 m, te shoqeruara me sistem kanalizimesh

Projekti te hartohet ne perputhje me te gjitha normat dhe standardet per projektim qe parashikon legjislacioni ne fuqi.

Projektimi duhet te siguroje respektimin e standadeve, madje edhe atyre gjate zbatimit.

Eshte pergjegjesi e projektuesit saktesia dhe respektimi i te gjitha standardeve dhe normave perkatese.

Projektuesi mund te rekomandoje edhe prezantimin e standardeve te reja, per perafrimin me normat e BE-se, si dhe te praktikave me te mira nderkombetare ne projektim dhe zbatim.

Rekomandimet duhet te permbajne elemente te fizibilitetit dhe realizueshmerise me praktiken shqiptare dhe limitimet per financimin e vepres.

Per trajtimin e gjelberimit e stolave, jane mare ne konsiderate rekomandimet qe jepen ne vendim Nr. 712, datë 29.10.2014, për miratimin e rregullores teknike "Për projektimin dhe ndërtimin e varrezave në territorin e republikës së Shqipërisë", kryesisht per zonen e re ndersa per rruget ekzistuese eshte parashikuar vetem segmenti 1, ndersa ne segmentet e tjera mund te shikohet mundesia per plotesime me keto elemente gjate fazes se zbatimit te punimeve.

Standarde ne paraqitjen e dokumentacionit teknik:

Ne hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit te projektit, Projektuesi te perdore programet e licensuara kompjuterike, si dhe te nxitet perdorimi i programeve te reja te licensuara, me te avancuara te fushes.

Ne hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik te projektit te mbahet parasysh dhe te respektohen te gjitha kerkesat dokumentare dhe te paraqitjes qe parashikojne kushtet teknike ne fuqi.

II. REALIZIMI I PROJEKTIT

II.1. OBJEKTIVAT

Objektivi i projektit është:

Ndërtimi i varrezave te qytetit.

II.2. DOKUMENTACIONI

Referuar kërkesës së Bashkisë Lezhë, hartimi i Projektit të Varrezave të Qytetit te Lezhës, duhet te permbaje:

1. Relacionin Teknik .
2. Hartimi i relievit topografik (kordinata lokale, kuota absolute)
3. Plan – vendosje te zones ku shtrihet objekti
4. Planimetria e segmenteve rrugore qe do te trajtohen.
5. Profilat tip
6. Detajet e ndryshme, per muret mbajtese e prites, veprat e largimit te ujerave dhe stukturat
7. Specifikimet teknike.
8. Preventivi dhe Grafiku i punimeve.

II.3. REKOMANDIME

Projektuesit duhet te mbledh gjithe informacionin e nevojshem qe i nevojitet per te realizuar projektin e zbatimit per kete objekt .

Cilesia e studimit duhet te jete e tille qe te arrihet standardi i kerkuar.

III. TE PERGJITHSHME

III.1. HYRJE

Objekti Ndertim i Varrezave te Qytetit te Lezhës, – Bashkia Lezhë, ndodhet ne territorin e Bashkise Lezhë.

Shtrihen në veri të qytetit të Lezhës. Ndodhen në rrugën “Rraboshtë”, Njësia Administrative Kallmet, Bashkia Lezhë. Vendodhja e sheshit ku është menduar ndërtimi i varrezave publike Merqi kufizohet:

Në veri kufizohet nga parcela private, në perendim kufizohet nga kanali ujitës, në lindje kufizohet nga rruga “Rraboshtë”, në jug kufizohet nga rruga Merqi.



Figure 1 Plan Rilevimi Kadastral i parceleës së varrëzave

Siperfaqja e truallit për zhvillim ku do ndërtohen Varrezat publike në fshatin Merqi është afer 50000 m2, ka një reliev të pjerrët. Ndërtimi është bazuar në Vendim Nr. 712, datë 29.10.2014, për miratimin e

rregullores teknike “Për projektimin dhe ndërtimin e varrezave në territorin e Republikës së Shqipërisë”. Kapaciteti fillestar është menduar rreth 4000 varre solide.

Duke pare gjendjen e varrezave aktuale te qytetit te Lezhës nga ana e Bashkise Lezhë eshte percaktuar zona ku do te Zgjerohen Varrezat e Qytetit te Lezhës ne Zonën Kadastrale 1783 parcelat me numur pasurie: 25, 26, 41 te cilat jane ne pronesi te Bashkise Lezhë. Si rezultat i tejmbushjes se siperfaqes se Varrezave te qytetit te Lezhës nga ana e Bashkise Lezhë jane identifikuar parcelat e mësipërme te cilat do te perdoren per rritjen e siperfaqes se varrezave te qytetit. Kompozimi i siperfaqes se percaktuar nga Bashkia Lezhë eshte bere duke u nisur nga nje modul baze sipas ”Figura 3.1 Organizimi i një parcele me varre solitare” e VKM Nr. 712, datë 29.10.2014.

Persa i perket ndertimit te infrastruktures eshte projektuar nje aks kryesore me dy kalim me gjeresi 6 m, i cili ka shtrirje veri – jug duke nisur nga aksi rrugor ekzistues (Rruga 1) i varrezave ekzistuese. Akset rrugore qe krijohen paralel dhe pingul me aksin kryesor nga pozicionimi i modulit baze sipas ”Figura 3.1 Organizimi i një parcele me varre solitare” perbejne rrugët me një kalim me gjeresi 4 m.

III.2. POZICIONI I OBJEKTIT

Objekti Ndertim i Varrezave te Qytetit te Lezhës, shtrihet ne veri-lindja te qytetit te Lezhës dhe ze nje siperfaqe rreth 50 mije meter katrore

Figure 2 Vendodhja e parcelës në raport me qytetin Lezhë

III.3. GJENDJA EKZISTUESE

IV.5.1. Topografia

Para fillimit te rilevimit u krye vezhgimi i terrenit, i cili sherbeu per percaktimin e sakte te metodikes se punes si dhe menyren e ndertimit te rrjetit gjeodezik, poligonometrise se rilevimit, nivelimit si dhe organizimit te punes.

Figure 3 Rilevimi topografik i parcelës

Rilevimi eshte bere ne sistemin nderkombetar me projeksionin UTM me elipsoid ËGS84. Duke patur parasysh zonen dhe ritmin e zhvillimit qe ajo ka, do te ishte me frytedhense nese do te perdorej dhe ky sistem.

Me kete sistem mund te percaktohet lehtesisht kordinatat gjeodezike per cdo pike mbi siperfaqen tokesore nepermjet perdorimit te GPS si dhe perdorimin e hartave dixhitale ortofoto sidomos per pozicion planimetrik meqenese behet fjale per te njejtin projeksion dhe elipsoid dhe duke pare qe dhe gjate zbatimit te projekteve instrumenti gps po gjen nje perdorim mjaft te gjere e ben te mundur lehtesisht zbatimin e projektit mjafton qe projekti te jete dixhital dhe mund te insertohet lehtesisht ne instrument .

Duke u mbeshtetur ne pikat e poligonometrise u zhvillua rrjeti i

matjeve topografike te planimetrise se zones te parashikuar per ndertimin e ketij objekti.

Jane kryer matje plotesuese ne te gjithe veprat e artit ekzistuese. Ne çdo rast jane rilevuar daljet e kanaleve, rrugeve te tjera, me qellim qe te parashikohen mire nga projektuesit kerkesat per tombino, vepra, kanale te shkarkimeve, etj.

Çdo pike e mare ne teren ka koordinata tre dimensionale, te paraqitura ne projekt. Gjate rikonicionit ne terren u vendosen pikat e poligonit dhe markat e nivelimit ne pikat e fiksuara ne teren. Pikat e fiksuara ne terren u plotesuan me koordinata ne projeksionin UTM elipsoid ËGS84.

Fiksimi ne terren i pikave te forta te (poligonit) u fiksua me gozhde betoni dhe hekur ne bordure betoni dhe boje te dukshme. Ato jane vendosur ne vende te dukeshme dhe te pa levizshme. Identiteti i tyre eshte fiksuar me boje te kuqe te shkruajtur ne afersi te pikes fikse ne vende te dukeshme nga rruga ekzistuese ose tereni. Ato jane vendosur ne vende te qendrueshme, ne ane te kanalit, kane pamje te ndersjellte, duke siguruar ne kete menyre lidhjen dhe vazhdimesine e punes nga faza e projektimit ne ate te zbatimit te tij.

Çdo pike e fiksuar ne terren ka numerin, koordinatat e saj, si dhe lartesine. Keto te dhena sigurojne gjetjen e tyre me lehtesi ne terren.

Punimet topogjeodezike te kryera jane mbeshtetur ne shkallen e plote te pergatitjes profesionale, ne perdorimin e teknologjive bashkekohore per matjet fushore dhe perpunimin kompjuterik te te dhenave, per te plotesuar kerkesat teknike te parashtruara nga projektuesit.

IV.5.2. **Pershkrimi i terrenit**

Ne vijim, jane paraqitur disa imazhe, te kryera nga inspektimi ne vend i zones ne te cilen do te ndertohet objekti.

Zona ku do te zgjerohen varrezat e Lezhës karakterizohet nga nje terren kodrinor me shtrirje Jug-Perëndim – Veri-Lindje me gjatesi rreth 180 m dhe Jug-Lindje – Veri-Perendim me gjeresi 170m. Terreni eshte i pozicionuar ne pjesen veriore të qytetit dhe shtrihet ne te majte te rruges Lezhe-Merqi.

Terreni karakterizohet pergjithesisht nga pjerresi qe shkojne nga 6% deri ne 15% me perjashtim te disa zonave te pozicionuara ne pjesen lindore e perendimore pjerresia e te cilave shkon deri ne 25%.

Terreni pergjithesisht eshte i mbuluar me vegjetacion te ulet me perjashtim te disa zonave ne pjesen veri – lindore ku ka vegjetacion te perbere nga shkurre e peme te larta.

Punimet gjeodezike dhe topografike, u kryen mbi bazen e kerkesave

teknike te pergjithshme dhe specifike te parashikuara nga Bashkia Lezhë. Para fillimit te punimeve topografike u siguruan materialet e nevojshme hartografike, gjeodezike si dhe pajisjet perkatese.

Figure 4 Foto nga zona gjate fazes I

Matjet gjeodezike per realizimin e projekt zbatimit jane kryer duke u mbeshtetur ne nje poligon me disa pika baze, dhe pika poligoni (pune) te hapur te shtrire pergjate objektit.

IV. ZGJIDHJA E PROJEKTIT

IV.1. SKEMA E ORGANIZIMIT

Siperfaqja e përdorur për zhvillim është e ndarë në zona në bazë të funksioneve.

Zona A - Zona e shërbimeve të përgjithshme e cila ka në përbërjen e saj

1. Hyrje e pajisur me portë me kangjellaMur rrethues (h-min = 2.5 m)
2. Zyra e rojës
3. Morgu
4. Tualete publike
5. Sallë ceremoniale
6. Zyra teknike dhe administrative
7. Magazina/hapësira teknike/furrë djegieje

Zona B - Zona e varrezave e cila ka në përbërjen e saj

1. Parcela varrimi për njerëz të shquar
2. Parcela për varrim vetiak, nëntokësorë
3. Parcela për varrim familjar, nëntokësorë
4. Struktura për varrimin mbitokësor të eshtrave
5. Struktura për varrimin mbitokësor të kufomave
6. Magazina e eshtrave

Zona C - Zona për reparte të veçanta

1. Krematori
2. Struktura për varrezat e hirit
3. Fushë për shpërndarjen e hirit

Zona D - Zona e hyrjes dhe e shërbimeve ndihmëse

1. Shitës lulesh
2. Parkime

Parcela ku do të ndërtohen Varrezat publike në fshatin Merqi do të ketë dy pika aksesi nga rruga “Rraboshtë”, ku të cilat do të shërbejnë si hyrje. Hyrjet janë të pozicionuara në anën lindore të parcelës dhe lidhen drejtpërdrejt me parkingjet e propozuara. Parkingjet kanë një kapacitet më të madh se 120 poste parkimi, ndërmjet tyre lidhen me një rrugë e cila zbret në kuotën e objekteve që janë menduar të ndërtohen me funksion shërbime. Rrethimi do realizohet me mur guri dhe me gabiona me rrjetë teli të zinguar, gurë kave 1x2x2m. Lartësia

minimale e murit rrethues është 2.5m.



Figure 5 Skema funksionale e varrezave

Në hyrjet e parashikuar do të vendosen porta metalike dekorative rreshqitëse.Për shkak të terrenit të thyer është menduar që terreni të sistemohet në tarraca në kuota të ndryshme. Ndarja e zonave do të realizohet me rrugë dhe trotuare që lejojnë aksesimin në çdo pjesë.

IV.2. FAZAT E ZHVILLIMIT

; **Faza e parë** – tregohet ne foton e meposhtme

jane ber germimet per rruget dhe muret perkatese qe

i perkasin zones

jane ndertuar muret mbajtes

Faza e dytë – parashikon ndërtimin e

- pjesës tjetër të parcelave të varrimit,
- ndërtimin e parkimit lindor, si dhe

- ndërtimin e objekteve dhe godinaeve mbështetëse
- ndertimin e shtresave rrugore, sinjalistikes dhe ndricimin rrugor

Në imazhin më poshtë është dhënë zonimi i zhvillimit të projektit të varrezave.



Figure 6 Faza II e zhvillimit

Në këtë project planifikohet të ndërtohet rrethimi që është i domosdoshëm për nisjen e operimit të varrezave.

Gjithashtu planifikohet të ndërtohet një mur mbrojtës në pjesën veriore për shkak të pjerrësisë së terrenit dhe prezencës kanalit të ujrave të larta në zonën limitrofe me parcelën e varrezës.

Parkimi hyrës është gjithashtu i domosdoshëm për sigurimin e aksesit në zonë.







Figure 7 Objektet e Sallës Ceremoniale dhe Morgut

Përveç godinës së rojes dhë atë të shërbimeve të luleve do të ndërtohen edhe dy godina me funksione të rëndësishme; (i) godina e Sallës së Ceremonive, dhe (ii) godinës së Morgut.

IV.3. KOMPOZIMI I SHESHIT TE NDERTIMIT TE VARREZAVE

Kompozimi i siperfaqes se percaktuar nga Bashkia Lezhë eshte bere duke u nisur nga nje modul baze të organizimi i një parcele me varre solitare e VKM Nr. 712, datë 29.10.2014, si dhe kerkesave te pikes 3 te kesaj VKM per organizimin e varreve ne parcela.

Figure 8 Organizimi i një parcele me varre solitare sipas VKM Nr. 712



Parcela baze eshte kompozuar me sipërfaqe rreth 1000 metra katrore, ku brenda saj përfshihen rrugicat e këmbësorëve, hapësirat ndërmjet varreve, si edhe gjelbërimi. Per te optimizuar siperfaqen ne

dispozicion parcela baze e kompozuar ka raporte te gjatësisë me gjerësinë afersisht 1x1.

Duke mbajtur ne konsiderate gjeologjine e terrenit ne te cilin do te ndertohen varrezat solitare largësia e varreve nga njëri-tjetri eshte mbajtur 0.50 m.

Varret jane parashikuar të vendosen në rreshta ku një rresht do të ketë 23 varre dhe ndermjet rreshtave jane parashikuar rrugë kalimi, me gjeresi 0.6 m dhe në çdo 8 rreshta një rrugicë kalimi me gjeresi 1.2 m. Brenda parcelës do të mundësohet kalim komod edhe për personat me aftësi të kufizuara.

Numri i varreve nëntokësore solitare në një parcelë eshte parashikuar të jetë 1500 varre. Numri i varreve, për kufomat deri 10 vjeç përbën rreth 10% të varreve brenda seiciles parcele.

Ne kete faze eshte parashikuar vetem konturimi i jashtem i parcelave qe praktikisht krijohet nga ndertimi / konturimi i rrugeve te kalimit te parashikuara ne projekt.

Çdo parcelë eshte parashikuar të rrethohet, në të katër anët, me rrugë që do te shërbejnë për qarkullimin e makinave të funeralit.

Persa i perket ndertimit te infrastruktures eshte projektuar nje aks kryesor me dy kalim me gjeresi 6 m, i cili ka shtrirje veri – jug duke nisur nga aksi rrugor ekzistues (Rruga Rraboshtes.

Akset rrugore qe krijohen paralel dhe pingul me aksin kryesor nga pozicionimi i modulit baze sipas skemës së organizimit të një parcele me varre solitare perbejne rrugët me dy kalime me gjeresi 2.5 m secili kalim.

Pas perfundimit te procesit te azhornimeve ne terren, ne si projektues kemi bere nje analize te shkurter te situates ne bashkepunim dhe me konsultim edhe me perfaqesuesit e Drejtorise se Sherbimeve, ku kemi marre edhe te dhenat e para mbi ecurine e planeve/studimeve dhe ndikimin e tyre ne projekt.

Qellimi i kesaj faze eshte qe projekti te kete analize te perputhshmerise me planet, efiçence ekonomike te nderhyrjes, pra efektivitet te kostos, minimizim te impakteve negative sociale (si p.sh te prishjeve te panevojshme, etj.

Duke qene se gjendja aktuale e terrenit pamundeson ndertimin e varrezave ne gjendje optimale, duke maksimizuar siperfaqen e shfrytezueshme por edhe duke mbajtur ne konsiderate udhezimet e VKM Nr. 712, datë 29.10.2014, nga ana e grupit te projektimit propozohet nderhyrje fillestare per ndertimin e infrastruktures rrugore nepermjet te ciles do te krijohen / konturohen edhe parcelat e parashikuara per ndertimin e varreve individuale te pershkruara me

siper. Mbas plotesimit te parcelave me varreza ne faza te tjera do te behet ndertimi i rrugicave, gjelberimit si dhe elementeve te tjere brenda seiciles parcele.

Figure 9 Ilustrime të varrezave

Më lart janë dhënë edhe disa ilustrime për realizimin e varrezave të qytetit Lezhë ku paraqiten terracimet e nevojshme për krijimin e parcelave të varrimit.

IV.4. REKOMANDIME

Nese gjate realizimit te punimeve niveli maksimal i ujërave nëntokësore duhet të jetë eshte me pak se 2.5-3 m nëntokë, atehere duhet të parashikohen sisteme drenazhimi te tokes ne ato zona qe haset kjo problematike.

Për të gjithë zonën është realizuar një studim hidro-gjeologjik. Sidoqoftë, perpara se te filloje shfrytezimi i parcelave qe do te

krijohen nga ky projekt, duhet të bëhen provat shtesë të tokes për të përcaktuar përbërësit kimiko- fizikë, porozitetin dhe përbërjen granulometrike të shtresës së tokës, per te vendosur per menyren e ndertimit te gropes se varreve sipas udhezimeve te VKM Nr. 712, datë 29.10.2014.

IV.5. INFRASTRUKTURA RRUGORE

Per ndertimin e infrastruktures rrugore eshte parashikuar konturimi i rrugeve (nepermjet te cileve do te krijohen edhe parcelat per varrezat individuale) me bordura te parafabrikuara ose mure prites / mbajtes ne funskion te pjerresise se terrenit, si dhe ndertimi i shtresave rrugore te cilat ne finale do te trajtohen me beton duke perpunuar siperfaqen per rritjen e aderneces.

Per te gjitha akset rrugore jane parashikuar te ndertohen rrjetet nentokesore inxhinierike per largimin e ujerave siperfaqesore, te cilat do te derdhen ne rrjetet ekzistuese te largimit te ujrave siperfaqesore.

Per cdo segment profila tip propozohen si më poshtë:

IV.5.3. **Segmenti rrugor me dy kalime.**

Më poshtë janë dhënë disa profile tip që do shërbejnë për të formatuar segmentë të ndryshme të rrugëve të brendshme të varrezave.

Profili Tip I me gjeresi te pjeses kaluese 6.0 m, e kufizuar ne te dy anet me bordure te parafabrikuar qe do te sherbejne edhe per konturimin e parcelave qe do te shfrytezohen per ndertimin e varrezave individuale. Ne te dy anet rruga do te kete kuneta qe do te sherbejne per mbledhjen e ujerave siperfaqesore.



Figure 10 Profile tip të rrugëve

Profili Tip II me gjeresi te pjeses kaluese 6.0 m, e kufizuar me bordure te parafabrikuar dhe mur mbajtes qe do te sherbejne edhe per konturimin e parcelave qe do te shfrytezohen per ndertimin e varrezave individuale. Ne te dy anet rruga do te kete kuneta qe do te sherbejne per mbledhjen e ujerave siperfaqesore.

Profili Tip III me gjeresi te pjeses kaluese 6.0 m, e kufizuar me bordure te parafabrikuar dhe mur mbajtes qe do te sherbejne edhe per konturimin e parcelave qe do te shfrytezohen per ndertimin e varrezave individuale. Ne te dy anet rruga do te kete kuneta qe do te sherbejne per mbledhjen e ujerave siperfaqesore.

Profili Tip IV me gjeresi te pjeses kaluese 4.0 m, e kufizuar ne te dy anet me bordure te parafabrikuar qe do te sherbejne edhe per konturimin e parcelave qe do te shfrytezohen per ndertimin e varrezave individuale. Ne mes rruga do te kete kunete qe do te sherbe per mbledhjen e ujerave siperfaqesore.

Profili Tip V dhe VI me gjeresi te pjeses kaluese 4.0 m, e kufizuar me bordure te parafabrikuar dhe mur mbajtes qe do te sherbejne edhe per konturimin e parcelave qe do te shfrytezohen per ndertimin e varrezave individuale. Ne mes rruga do te kete kunete qe do te sherbe per mbledhjen e ujerave siperfaqesore.

IV.5.4. **Profilet**

Per ndertimin e infrastruktures rrugore duke qene se te gjitha rruget jane te reja eshte vleresuar te perdoren shtresat sipas profileve të mëposhtme. Per permiresimin e pjerresive natyrale te terrenit jane parashikuar te ndertohen disa struktura mbajtese e pritese. Duke qene parcele e re, eshte parashikuar gjithashtu edhe rrethimi i te gjithe parceles, duke ju bashkengjitur varrezave ekzistuese.

Per segmentet ku eshte parashikuar sistemimi i pjerresive natyrale, jane parashikuar te ndertohen mure prites me lartesi te ndryshme, sipas rasteve.



Figure 13 Profil i rrugëve brenda parcelave



Figure 14 Profil i Murit Prites

Muret rrethuese do te jene me blloqe betoni te shoqeruar me kollona

dhe kontruksion metalik (kangjell), ne afersi te te cilit eshte parashikuar nje hapesire e lire per gjelberimin e te gjithe perimetrit.

Per te gjitha akset e reja eshte parashikuar gjelberimi dhe arredimi urban (instalimi i stolave dhe koshave te plehrave) i cili do te realizohet edhe ne perimeter te rrethimit te ri si dhe pergjate anes se majte te segmentit rrugor te pare. Te shikohet mundesia e plotesimeve me keto elemente edhe ne ndonje zone pergjate akseve ekzistuese, ose pergjate shkallareve ekzsituese.

IV.6. Konkluzione

Ndertimi i Varrezave te Qytetit te Lezhës, eshte nderhyrje e domosdoshme dhe urgjente per te krijuar nje hapesire te re dhe te sistemuar per zgjerimin e varrezave te qytetit te Lezhës.

- Nepermjet ketij zgjerimi do te krijohen parcela per nje kapacitet te pergjithshem prej 4.000 varreve nëntokësore solitare.
- Ne kete projekt eshte parashikuar ndertimi i infrastruktura mbeshtetese te domosdoshme per te aksesuar e perdorur cdo zone te sheshit te parashikuar per zgjerimin e varrezave te qytetit te Lezhës.
- Ne kete projekt eshte parashikuar ndertimi i nje aksi kryesor me dy kalime me gjeresi 6 m.
- Akset rrugore qe krijohen paralel dhe pingul me aksin kryesor nga pozicionimi i modulit baze sipas skemës së organizimit i një parcele me varre solitare perbejne rrugët me një kalim me gjeresi 4 m.
- Infrastruktura do te beje te mundur levizjen e banoreve te qytetit te Lezhës si gjate ceremonive mortore ashtu edhe gjate ceremonive te tjera, apo mirembajtjes se parcelave te krijuara apo varrezave qe do te ndertohen.
- Ne kete projekt eshte parashikuar vetem konturimi i jashtem i parcelave (me bordura te parafabrikuara apo mure) qe praktikisht krijohet nga ndertimi / konturimi i rrugeve te kalimit te parashikuara ne projekt, te cilat do te mund te perdoren per ndertimin e varreve nëntokësore solitare.
- Çdo parcelë eshte parashikuar të rrethohet, në të katër anët, me rrugë që do te shërbejnë për qarkullimin e makinave të funeralit.
- Ne kete projekt jane parashikuar edhe disa elemente gjelberimi dhe stola te cilat do te pozicionohen ne zona te lira ne ane te rrugeve apo ne afersi te murit rrethues ne perimeter te parceles.

Petrit Muja

Digitally signed by Petrit Muja
Date: 2026.07.13 11:53:39 +02'00'